

Data _____

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Mirëmbajtja e platformës elektronike të blerjes së energjisë elektrike.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Mirembajtja e Softwareve te Teknologjise se Informacionit.

VLERA E FONDIT LIMIT: 3.600.000 (Tre milion e gjashtëqind mijë) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP sh.a, ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Qellimi i këtij shërbimi është “Mirëmbajtja e platformës elektronike të blerjes së energjisë elektrike”, për një periudhë 1 (një) vjeçare.

Objekti i përgjithshëm i këtij prokurimi është mirembajtja e platformës ekzistuese elektronike të blerjes së energjisë elektrike për komponentet e mëposhtëm, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës.

Mirëmbajtja e platformës elektronike ekzistuese të blerjes së energjisë elektrike nënkupton pjesëmarrjen e të dy palëve, secili me aktivitetin përkatës, të ndarë parimisht në këto dy grupe:

- **Përfituesi i shërbimit, FTL SH.A,** ka për detyrë të kujdeset për mirëpërdorimin e sistemit, ambjentin ku është instaluar, të trajtojë përdoruesit e brëndshëm, të kërkojë në kohën dhe mënyrën e duhur suport për çështje teknike që nuk arrijnë t’i zgjidhin vetë.
- **Ofruesi i shërbimit,** ka për detyrë të zgjidhë problemet teknike të sistemit software të implementuar dhe dorëzuar në përfundim të periudhës së garancisë, referuar kërkesave për suport të Përfituesit, të japë informacion për sistemin dhe integrimin e mundshëm të tij me sisteme të tjera.

Qëllimi i kësaj platforme është të sigurojë rregulla dhe procedura të thjeshta për operime të shpejta, bazuar në një proces konkurrues dhe transparent për realizimin e blerjes së energjise elektrike pa cenuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike të klienteve.

Nisur nga procesi i kompleks i punes dhe infrastruktura qe duhet ngritu per zbatimin e kesaj kontrate dhe nga ana e OSHEE GROUP sh.a, kjo procedure nuk mund te ndahet ne lote, pasi eshte e pamundur te ndash pergjegjсите dhe Kohen e reagimit ne rast problemi.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 1,400,000 (Nje milion e katerqind mije) leke.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera 1,400,000 (Nje milion e katerqind mije) leke, eshte 38.8 % e fondit limit te percaktuar, jo me shume se 40 %. Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Vlera e përcaktuar e xhiros i shërben autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përbushjen me sukses të kontratës. Objekti i kësaj kontrate.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit të Prokurimit Publik, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe parashikimet e legjislacionit të fushës, aktualisht nenit 29, të Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Per Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij Ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021, 2022**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter i shërben autoritetit/entitetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 29, të Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Per Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij Ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 700,000 (Shtatëqind mijë) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një entitet publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4, shkronja ”b” e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar

kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **19 % e fondit limit të përcaktuar, jo më shumë se 20 %**.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare. Për këtë arsye, operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë certifikatat e mëposhtme të vlefshme në datën e hapjes së tenderit të perkthyer dhe të noterizuara:

a) **ISO 9001:2015** ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme).

b) **ISO 27001:2013** ose ekuivalente për Sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit” (e vlefshme).

c) **ISO/IEC 20000-1** ose ekuivalente për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (e vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi ISO 9001 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

Certifikimi ISO 27001 ose ekuivalent është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos cenohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike.

Ky standard është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe Specifikimet Teknike pasi ky objekt prokurimi përfshinë implementimin, adaptimin, testimin, shpërndarjen dhe instalimin e të gjitha informacioneve teknike të sistemit.

ISO/IEC 20000-1 ose ekuivalente është i nevojshëm pasi siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre, gjithashtu shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjise së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

2.3.3 Operatori ekonomik Ofertues duhet të disponojë minimalisht 6 punonjës, ku:

- **Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e informacionit.**
- **Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për mbështetjen e projektit sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente**
- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për siguri në rrjetat kompjuterike**
- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim databaze**
- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testim software**

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Listepagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën Tetor 2023 të konfirmuara nga administrata tatimore.

Për të përmbushur këto kritere, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë dhe certifikimet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, me njoftimin praparak të fituesit, të gjitha dokumentat e vetëdeklaruarat do të dorëzohen pranë AK origjinale ose kopje të noterizuara.

SHENIM: *Një punonjës mund të ketë 1 ose disa certifikime.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin minimal të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

- **Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e informacionit.**

Argumentim: Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të vërtetojë që punonjësi me certifikimin në sigurinë e informacionit, pjesë e stafit teknik të operatorit ekonomik, ka aftësi të planifikojë, të udhëheqë, të raportojë dhe të auditojë menaxhimin e sigurisë së informacionit në funksion të platformës që do të zhvillohet dhe mirëmbahet, si dhe të garantojë që sistemi është konform standardeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, në të gjithë hallkat funksionale

të tij, duke mundësuar kështu menaxhimin në mënyrë të sigurt të informacionit. Prania e tij jep garanci për sigurinë e informacionit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës

- **Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për mbështetjen e projektit sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente**

Argumentim: Një certifikim ITIL është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kërkesa për certifikim ITIL ose ekuivalente, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të certifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të kontratës në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes. Kjo kërkesë përforcon kërkesën për certifikim ISO 20000, auditimet periodike për ricertifikimin e të cilit, duke qenë se bëhen mbi baza vjetore nuk garantojnë apriori që operatori ekonomik ka në përbërjen aktuale të stafit të tij personel të kualifikuar që ndjek dhe mbikqyr projektet në nivel operacional bazuar mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të menaxhimit të shërbimeve IT.

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për siguri në rrjetat kompjuterike**

Argumentim: Kjo kërkesë lidhet me praninë në stafin implementues të Operatorit, të një specialisti të sigurisë në rrjetat kompjuterike që nevojitet gjatë implementimit dhe konfigurimit të pajisjeve hardware, rrjetit LAN dhe për ndërhyrjet që mund të nevojiten përgjatë mirëmbajtjes të licencës për Firewall si dhe përgjatë periudhës 24 (njëzet e katër) të ofrimit të shërbimit

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim databaze**

Argumentim: Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë që Operatori Ekonomik ofertues është i aftë për administrimin e databazës aktuale dhe mirëmbajtjen eficiente të saj. Mënyra më e saktë dhe që paraqet më pak risk për konfirmimin e aftësive të stafit është pajisjame certifikata, dhe paraqitja e tyre si dëshmi kualifikimi. Prania e tyre jep garanci për implementimin e detyrave të kontratës bashkë me shërbimet e mirëmbajtjes 24 mujore dhe operimine sigurt me elementët përbërës të databazës.

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testim software**

Argumentim: Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë që Operatori Ekonomik ofertues është i aftë për testimin e sistemit aktual dhe mirëmbajtjen eficiente të tij. Mënyra më e saktë dhe që paraqet më pak risk për konfirmimin e aftësive të stafit është pajisjame certifikata, dhe paraqitja e tyre si dëshmi kualifikimi. Prania e tyre jep garanci për implementimin e detyrave të kontratës bashkë me shërbimet e mirëmbajtjes 24 mujore dhe operimine sigurt me elementët përbërës të databazës.

Argumentimi i specifikimeve dhe termave te references

Shënim: specifikimet teknike, për shërbimin objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe të pajisjeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, janë pjese ne DST e kesaj procedure.

Në specifikimet teknike, objekti i kontratës, nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Shënim:

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.